



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2021:017441

Datë: 18.03.2021

Numri i dokumentit: 01607114

P.nr.29/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtari Sulltan Dobraj dhe më pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha në çështjen penale kundër te pandehurës V. Sh. nga fsh.K-....., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës se PTH-ës në Pejë PP/II.nr.123/2021 te dt.27.01.2021 duke vendosur mbi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në bazë të nenit 495 të KPPK-ës jashtë shqyrtimit gjyqësor më dt.**17.03.2021**, ka marrë këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET KËRKESA PËR DHENIEN E URDHËRIT NDËSHKIMOR e PTH në Pejë departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.123/2021 te dt.12.03.2021.

E pandehura **V. (A.) Sh.** lindur me dt..... në fsh K-....., ku dhe banon me nr. Personal: 1002397940, shqiptare, shtetase e R. Kosovës, mbrohet në liri.

ESHTË FAJTORE

Për arsye se:

Më parë e deri me datë 15.01.2020 në, pikërisht në shtëpinë e saj, siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm me shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të furnizimit më rrym elektrike, në atë mënyrë që pas vizitës së bërë nga ana e komisionit të autorizuar KEDS të konsumatoria ne fjalë është hasur se blloba distributive e ormanit ishte e këputur (mungonte) e po ashtu edhe blloba e njehsorit me nr. 44171451, pra në njehsor ishin të kyçura hyrjet-daljet e L1 të bashkuara, dhe me këtë veprim e ka anashkaluar njehsorin elektrik i cili e kishte për të matur shpenzimin e kilovatëve të konsumuar, ashtu që në mënyrë të pa autorizuar ka shpenzuar energjinë elektrike me ç 'rast të dëmtuarës KEDS i ka shkaktuar dëm material.

-me çka ka kryer vepër penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 te KPRK-së.

Andaj gjykata, konform nenit 7,17, 38, 43, 314 par.1 te KPK-së dhe nenit 493, 495, 496 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- I. Në mënyrë që ia përcakton dënimin me gjobë në lartësi prej **100 (njëqind) €**, të cilin dënim i dënuari duhet ta paguan në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i dënuari nuk e paguan gjobën pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi të paraparë në piken I te këtij diapozitivi, gjykata do të bëjë zëvendësimin e dënimit e gjobë në dënim me burg dhe atë në **5 (pesë) ditë burgim**, duke llogaritur një dit burgim për çdo 20 € të gjobës.
- III. E dëmtuara KEDS ne Pejë për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.
- IV. E pandehura obligohet që në emër të paushallit gjyqësorë gjykatës ti paguan shumën prej 25 euro, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 euro, ndërsa për shpenzimet e procedurës penale gjykata do të vendos me aktvendim te veçantë nëse gjënë shpenzime te tilla.

A r s y e t i m

PTH në Pejë ka ushtruar aktakuzë PP/II.nr.123/2021 te dt.27.01.2021, kundër të pandehurës V. Sh. nga fshK-....., për veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPK-ës dhe ka kërkuar nga gjykata që kundër te njëjtit te caktohet dhe te mbahet shqyrtimi gjyqësorë ku i njëjti te shpallet fajtor dhe te dënohet sipas ligjit.

PTH në Pejë, ka bërë kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me nr. PP/II.nr. 123/2021 te dt.27.01.2021, kundër të pandehurës V. Sh. nga fsh.K-..... duke propozuar që të njëjtit ti shqiptohet dënimi me gjobë.

Gjykata gjatë vlerësimit të kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor ka vlerësuar se kërkesa për dhënien e urdhrin ndëshkimorë PP/II.nr.123/2021 te dt.12.03.2021, **është e bazuar.**

Më parë e deri me datë 15.01.2020 në Deçan, pikërisht në shtëpinë e saj, siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm me shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të furnizimit më rrym elektrike, në atë mënyrë që pas vizitës së bërë nga ana e komisionit të autorizuar KEDS të konsumatoria ne fjalë është hasur se blloba distributive e ormanit ishte e këputur (mungonte) e po ashtu edhe blloba e njehsorit me nr. 44171451, pra në njehsor ish-in të kyçura hyrjet-daljet e L1 të bashkuara, dhe me këtë veprim e ka anashkaluar njehsorin elektrik i cili e kishte për të matur shpenzimin e kilovatëve të konsumuar, ashtu që në mënyrë të pa autorizuar ka shpenzuar energjinë elektrike me ç 'rast të dëmtuarës KEDS i ka shkaktuar dëm material.

Gjendja faktike është vërtetuar më shikimin dhe leximin e procesverbalit nr.2193337 të datës 15.01.2020 të përpiluar nga punëtorët e KEDS-it në emër të Valbona Adem Shala foto dokumentacionit dhe shkresat tjera te lendes.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje të thellë se me të njëjtin do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë më nenin 38 të KPRK-së, duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurës ,shkallen e rrezikshmërisë shoqërore, dhe në këtë mënyrë do të ndikoj në arritjen e qëllimit të dënimit, si mase për parandalimin e te pandehurit por edhe si mase për parandalimin e te pandehurit dhe personave të tjerë kryes potencial te veprave penale nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim është marre konform nenit 43 par.3.të KPK-së

Gjykata në bazë të nenit 463 të KPPK-ës te dëmtuarën KEDS e ka udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike në shumë prej 380.25 euro sepse gjykata në shkresat e lendes ka hasur në një faturë për rikthim të humbjeve në emër të Valbona Adem Shala të përpiluara nga e dëmtuara , te cilave fatura gjykata nuk i ka falur besimin gjersa nuk janë të përpiluara nga një ekspert i pa varur.

Gjykata në bazë të nenit 453 të KPPK e ka obliguar te pandehurën që gjykatës ti paguaj paushallin gjyqësorë në shumë prej 25 euro, ndërsa për shpenzimet e procedurës gjykata do të vendos me aktvendim të veçantë.

Gjykata në bazë të nenit 39 paragraf 3 nën paragraf 3.1 të ligjit nr.05/L-036 për kompensimin e viktimave e ka obliguar të pandehurin në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën 30 euro.

**NGA GJYKATA THEMELORE PEJË-Dega NË DEÇAN,
P. nr. 29/2021 te dt.18.03.2021**

**Sekretare juridike,
Sabiha Hoxha**

**Gjyqtari
Sulltan Dobraj**

UDHËZIM JURIDIK:

*Kundër këtij aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej **8 ditësh**, nga dita e marrjes, duke ju drejtuar kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit nëse kundërshtimi nuk paraqitet urdhri ndëshkimorë merr formën e prerë.*